

GRUPI I GRAVE TË KUVENDIT - SUHAREKË

RAPORT PUNE

Periudha 2022-2025

Shtator, 2025

Përmbajtja

1. Parathënie.....	3
2. Grupet e Grave në të kaluarën – një përmbledhje e shkurtër historike.....	3
3. Grupi i Grave të Kuvendit 2022-2025	5
3.1. Përbërja dhe bashkëpunorët	5
3.2. Aktivitetet kryesore të realizuara nga Grupi i Grave (2022–2025).....	6
3.2.1. Avokimi dhe vendimmarrja.....	7
3.2.2. Aktivitete	8
3.3. Bashkëpunimi ndërkomunal dhe rrjetëzimi	11
3.4. Projektet dhe iniciativat strategjike	12
4. Sfidat kryesore për t’u adresuar në mandatin e ardhshëm	13
5. Përfundim nga Grupi i Grave (2022–2025)	15

Lista e fotografive

Foto 1: Grupi i Grave të Kuvendit dhe Nënkryetarja e Komunës	6
Foto 2: Mamografi pa pagesë - vendim nga Kuvendi	7
Foto 3: Shpërndarja e mirënjohjeve për biznese Gruas në Vendimmarrje’	8
Foto 4: Tryezë diskutimi ‘Pozita e	
Foto 5: Vizitë në QKMF	9
Foto 6: Vizitë në QSGF.....	9
Foto 7: Aktivitet për shënim të Muajit Rozë ndriqimi i urës portokalli.....	9
Foto 8: Mini paradë e heshtur dhe	
Foto 9: Aktivitet në kuadër të Muajit Rozë Ademaj	10
Foto 10: Protestë për Liridona	
Foto 11: Aktiviteti me moton ‘Eja, mos hezito’	10
Foto 12: Aktiviteti me moton ‘Eja, mos hezito’	10
Foto 13: Vizitë Strehimore në Prizren	11
Foto 14: Takimi i Mekanizmit kundër dhunës në familje.....	11
Foto 15: Pjesëmarrje në ekspozitën "Bota ime"	11
Foto 16: Vizitë bizneseve përfituese të subvencioneve komunale për start-up biznese.....	13
Foto 17: Event i organizuar nga Vivienne Academy në bashkëpunim me GGK	13

1. Parathënie

Përfaqësimi i grave në vendimmarrje është themelor për një demokraci funksionale, gjithëpërfshirëse dhe të drejtë. Roli i grave në Kuvendet Komunale nuk është vetëm simbolik – ai është thelbësor për hartimin e politikave që reflektojnë realisht nevojat, përvojat dhe aspiratat e gjithë qytetarëve. Përmes pjesëmarrjes aktive, gratë kontribuojnë në ndërtimin e institucioneve më të ndjeshme ndaj çështjeve sociale, barazisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky raport përmbledh punën katërvjeçare të Grupit të Grave të Kuvendit Komunal të Suharekës gjatë mandatit 2022–2025. Ai ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të angazhimeve tona, iniciativave të ndërmarra, sfidave të hasura dhe ndikimit të drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së grave dhe komunitetit tonë. Raporti synon gjithashtu të forcojë kulturën e llogaridhënies publike dhe të shërbejë si një dokument referues për grupet që do të vijnë në të ardhmen.

Gjatë këtij mandati, Grupi i Grave ka luajtur një rol të rëndësishëm në avokimin për barazi gjinore, fuqizimin e grave në jetën publike dhe mbështetjen e iniciativave që prekin drejtpërdrejt mirëqenien e qytetareve dhe qytetarëve të komunës sonë. Në bashkëpunim të ngushtë me Zyrtaren për Barazi Gjinore, znj. Habibe Bytyçi dhe me Nënkryetaren e Komunës, znj. Mihrije Suka, kemi ndërtuar ura bashkëpunimi dhe kemi krijuar hapësira më të mëdha për përfshirjen e grave në procese vendimmarrëse.

2. Grupet e Grave në të kaluarën – një përmbledhje e shkurtër historike

Grupi i parë i Grave në Komunën e Suharekës është themeluar me **vendim të Kuvendit Komunal nr. 01-Nr-16-7362, të datës 30.11.2011**, si një hap domethënës drejt institucionalizimit të pjesëmarrjes aktive të grave në proceset vendimmarrëse në nivel lokal. Pas marrjes së vendimit, është hartuar edhe Rregullorja e Punës e Grupit të Grave, e cila shërben si mjet funksionalizimi i grupit. Themelimi i këtij grupi bëhet në fillim të çdo mandati, ku anëtare me automatizëm janë të gjitha gratë anëtare të kuvendit të cilat për zgjedhin kryesinë e grupit. Ky grup përfaqëson një angazhim të qartë të kuvendit për të ndërtuar mekanizma për fuqizimin e grave në politikë dhe për të nxitur barazinë gjinore si pjesë të zhvillimit demokratik të komunës.

Në vitet e para të funksionimit, grupi është përballur me sfida të shumta – duke filluar nga **numri i vogël i grave në përbërjen e kuvendit**, mungesa e përvojës në punën me struktura të organizuara gjinore, e deri te **konteksti i përgjithshëm social dhe politik**, që nuk e kishte lehtësuar angazhimin aktiv dhe të barabartë të grave në vendimmarrje. Për më tepër, mungesa

e burimeve të dedikuara financiare dhe mbështetjes teknike i ka kufizuar mundësitë për realizimin e aktiviteteve më të strukturuar apo përfaqësimin në nivele më të gjera.

Megjithatë, përkundër këtyre vështirësive, grupet e mëhershme të grave kanë arritur të krijojnë një **bazë të qëndrueshme** për fuqizimin e rolit të gruas në kuvend, duke ndërtuar themelet mbi të cilat është vazhduar puna në vitet pasuese. Iniciativat e para, bashkëpunimet me akterë institucionalë dhe shoqërinë civile, si dhe përfshirja graduale në diskutime që prekin interesin e komunitetit kanë ndihmuar në rritjen e vetëdijes dhe fuqizimin e zërit të grave në politikë.

Ky **kontinuitet institucional dhe përvojë e akumuluar** ndër vite ka qenë thelbësor për funksionimin dhe avancimin e punës së grupit gjatë mandatit 2022–2025. Grupi aktual ka ndërtuar mbi përvojat e mëparshme, duke rritur dinamikën e veprimit dhe zgjeruar ndikimin në agjendën vendore, veçanërisht në fushat që prekin drejtpërdrejt jetën e grave, fëmijëve dhe komunitetit në përgjithësi.

Gjatë mandateve të kaluara, grupet e grave kanë arritur të organizojnë takime vetëdijësuese me gra në komunitet, të sjellin në vëmendje të kuvendit çështje që prekin drejtpërdrejt jetën e grave dhe fëmijëve, si dhe të përfaqësojnë komunën në forume dhe trajnime rajonale. Ato kanë ndërtuar ura bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile vendore dhe ndërkombëtare dhe kanë kontribuar në fuqizimin e rolit të gruas në jetën publike të Suharekës. Më poshtë gjeni disa nga të arriturat:

1. Pagesa për lehonat që lindin në QKMF – Suharekë, në vlerë prej 250€.
2. Memorandumi i Mirëkuptimit për pagesën vjetore - Strehimores në Prizren në vlerë prej 2200€.
3. Krijimi i Fondit Emergjent për Policinë e Kosovës dhe Qendrën për Punë Sociale, me dedikim për viktimat e dhunës në familje.
4. Përparësi në bonus banim për gratë viktime të dhunës në familje.
5. Subvencione për gratë e prekura nga kanceri i gjirit - 99 raste me vlerë 150€.
6. Lirimi nga pagesa e shërbimit të mamografit për muajin tetor (muaji rozë)
7. Kërkesa për objekt të qëndrimit ditor për fëmijët me Autizëm dhe Down Sindromë (realizuar nga një donator lokal, në vitin 2023).
8. Kërkesa për 1 çerdhe - janë realizuar 8.
9. Ndriqim publik në fshatra.

10. Pjerrina në rrugët e qytetit për nënat që përdorin karroca për fëmijë dhe për personat me aftësi të kufizuara.

11. Subvencionimi i nënave që kanë fëmijë me autizëm dhe Down sindromë, në vlerë totale prej 10,000 €.

3. Grupi i Grave të Kuvendit 2022-2025

3.1.Përbërja dhe bashkëpuntorët

Gjatë mandatit 2022–2025, Grupi i Grave të Kuvendit është përbërë nga 13 anëtare, të zgjedhura nga subjekte të ndryshme politike. Kjo përbërje e larmishme ka kontribuar në pasurimin e diskutimeve, bashkëpunimin ndërpartiak dhe përfaqësimin më të gjerë të interesave të qytetareve dhe qytetarëve. Për herë të parë në këtë mandat, përfaqësimi i grave në kuvend është në këtë numër dhe me përfaqësim mbi 40%.

Anëtares e grupit:

1. **Sanie Kuqi Rexhepaj** – Kryesuese
2. **Doruntina Zenelaj** – Nënkyesuese
3. **Saranda Bajraktari Rexhepi** – Sekretare
4. **Afërdita Mamaj**
5. **Bulëza Kuqi**
6. **Elmaze Bytyci**
7. **Festë Kabashi Kicaj**
8. **Fidaije Kukaj**
9. **Jehona Lumi Rrafshi**
10. **Laureta Tafaj**
11. **Mevlyde Kabashi**
12. **Mimoza Bajraktari**
13. **Shyqerije Zyrapi**

Anëtarët kanë marrë pjesë në komisione të ndryshme të kuvendit, kanë kontribuar në debatet e brendshme dhe kanë përkrahur iniciativa që lidhen me mirëqenien e komunitetit dhe avancimin e barazisë gjinore.

Gjatë mandatit, grupi ka realizuar një **bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me Nënkyetaren e Komunës, znj. Mihrije Suka**, e cila ka qenë mbështetëse e palëkundur e punës dhe iniciativave të grupit. Po ashtu, bashkëpunimi me **Zyrtaren për Barazi Gjinore, znj. Habibe Bytyçi**, ka qenë kyç në koordinimin e aktiviteteve dhe avancimin e agjendës gjinore në nivel komunal.



Foto 1 Grupi i Grave të Kuvendit dhe Nënkyetarja e Komunës

Grupi ka bashkëpunuar gjithashtu me **drejtoreshat e drejtorive komunale**, në veçanti në çështje që lidhen me shëndetësinë, mirëqenien sociale, kulturën dhe zhvillimin ekonomik të grave. Nuk mungoi as mbështetja institucionale nga **Kryetari i Komunës z.Bali Muharremaj**, i cili ka qenë i gatshëm të ofrojë mbështetje financiare për iniciativat nga ky grup. Bashkëpunimi ka qenë i pashmangshëm me **Kryesuesin e Kuvendit Komunal z.Bexhet Kuçi** dhe asambleistët (burra) nga mandati 2022-2025.

3.2.Aktivitetet kryesore të realizuara nga Grupi i Grave (2022–2025)

Gjatë mandatit, Grupi i Grave ka qenë aktiv dhe i përkushtuar në realizimin e një sërë aktiviteteve që synojnë fuqizimin e grave, promovimin e barazisë gjinore dhe përmirësimin e jetës së komunitetit. Përmes bashkëpunimit institucional, fushatave vetëdijësuese dhe avokimit në vendimmarrje, grupi ka kontribuar në ngritjen e zërit të grave dhe adresimin e sfidave të tyre në nivel lokal.

Ky grup ka funksionuar në bazë të Rregullores së Punës e miratuar në Kuvendin Komunal 01Nr.16-2546 të datës 26.04.2012 dhe planeve vjetore të hartuara dhe miratuara nga vet grupi. Puna dhe angazhimi është bërë tërësisht në formë vullnetare. Përmes takimeve të rregullta, ky grup ka funksionuar me unitet të plotë, përtej vijave politike dhe me bashkëpunim të mirë legjislativ dhe ekzekutiv.

3.2.1. Avokimi dhe vendimarrja

Gjatë këtij mandati, Grupi i Grave ka qenë një zë i fuqishëm në Kuvendin Komunal për promovimin e çështjeve që prekin drejtpërdrejt gratë dhe komunitetin në përgjithësi. Përmes propozimeve konkrete dhe pjesëmarrjes aktive në diskutime, kemi avancuar iniciativa për përmirësimin e kushteve të jetesës, mbrojtjen e të drejtave të grave dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së tyre në vendimarrje. Një fokus i veçantë i është kushtuar luftës kundër dhunës në familje, ku kryesuesja e grupit, ka përfaqësuar anëtarët në Mekanizmin Komunal kundër Dhunës në Familje, duke siguruar koordinim dhe bashkëpunim ndërinstitucional për mbrojtjen dhe ndihmën ndaj viktimave.

Grupi është angazhuar fuqishëm që buxheti komunal, gjatë fazave të planifikimit, të përshijë propozimet e dala nga grupi, lidhur me nevojat e grave dhe vajzave të komunës. Ky angazhim ka ndikuar që buxheti i Komunës së Suharekës të jetë **buxhet i ndjeshëm gjinor**.

Në kuadër të përpjekjeve tona për të përmirësuar shërbimet për gratë, kemi arritur të miratojmë në Kuvend Komunal vendimin që **mamografia të ofrohet pa pagesë gjatë gjithë vitit, jo vetëm në muajin tetor**, duke garantuar kështu një qasje më të lehtë dhe të vazhdueshme ndaj shëndetit të grave.

Gjithashtu, kemi inicuar dhe miratuar vendimin si masë afirmative me qëllim të arritjes së përfaqësimit të barabartë, që **legalizimi i shtëpive që janë në bashkëpronësi (burrë dhe grua) ose në emër të gruas të bëhet pa pagesë**, duke eliminuar barrën financiare dhe duke synuar të ndikojmë në regjistrimin e sa më shumë paluajtshmërive në emër të grave, për të fuqizuar pronësinë dhe pavarësinë e tyre ekonomike.



Foto 2 Mamografi pa pagesë - vendim nga Kuvendi

Për më tepër, kemi avokuar me përkushtim që **vlëra mbështetëse në marrëveshjen ndërkomunale ndërmjet komunave rajonale dhe Qendrës për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Prizren të rritet nga 2200 Euro në 4000 Euro** në vit si mbështetje nga komuna jonë, duke siguruar një ndihmë më të madhe dhe më të qëndrueshme për gratë dhe fëmijët që kanë nevojë për strehim dhe mbrojtje.

Përmes këtyre veprimeve konkrete, kemi punuar për të fuqizuar rolin e grave në shoqëri dhe për të siguruar që politika lokale të reflektojë nevojat reale të komunitetit tonë.

3.2.2. Aktivitete

Grupi i Grave ka qenë pjesë e organizimit të aktiviteteve dhe tryezave të diskutimit, sidomos në ditë dhe periudha që shënojnë ngjarje të rëndësishme për gratë, si dhe ka qenë mbështetëse në çdo organizim tjetër të përkrahur nga komuna apo organizatat joqeveritare.

Aktivitetet në vitin 2022:

- Tryeza diskutimi në bashkëpunim me OSBE për Ditën Ndërkombëtare të Gruas “8 Marsi” me temën: **“Pozita e gruas në vendimmarrje në Komunën e Suharekës”**.
- Hapja e ekspozitës **“Më shumë se kaq”** nga krijueset shqiptare.
- Shpërndarja e mirënjohjeve për **10 gra të suksesshme në menaxhim dhe ngritje të biznesit**.



Foto 3 Shpërndarja e mirënjohjeve për biznese



Foto 4 Tryezë diskutimi ‘Pozita e Gruas në Vendimmarrje’

- Shpërndarje e luleve për:
 - Gratë në Shtëpinë e Pleqve në Gjinoc,
 - Gratë e vetmuara,
 - Gratë kalimtare në sheshin e qytetit.
- Vizita në institucione dhe organizata, përfshirë:
 - Shkollat që udhëhiqen nga gratë,
 - Organizatën Handikos,
 - Qendrën për strehimin e grave dhe fëmijëve,
 - Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF),
 - Shtëpinë e të moshuarve në Gjinoc



Foto 5 Vizitë në QKMF



Foto 6 Vizitë në QSGF

- Pjesëmarrje në organizimin e Handikos për nder të **3 Dhjetorit – Ditës së Personave me Aftësi të Kufizuara**.
- Aktivitet për shënim të Muajit Rozë, takim me të prekurat nga kanceri i gjirit - Marshim me gra aktiviste.
- Tryezë diskutimi me temën: **“Dhuna në baza gjinore”**, në kuadër të fushatës **“16 ditë aktivizëm kundër dhunës në baza gjinore”**.
- Mini paradë e heshtur dhe ndriqimi i urës me dritë portokalli, si shenjë solidariteti me viktimat e dhunës – aktivitet i mbështetur nga UNDP.



Foto 7 Aktivitet për shënim të Muajit Rozë



Foto 8 Mini paradë e heshtur dhe ndriqimi i urës portokalli

Aktivitetet në vitin 2023:

- Pjesëmarrje në tryezën **“Të drejtat e trashëgimisë për gratë dhe burrat”**, organizuar nga OSBE,
- Aktivitet në kuadër të **“Ditës Ndërkombëtare të Gruas 8 Marsi”** me nënat dhe gratë e dëshmorëve. Mirënjohje për dy gra që ndër të parë kanë hapur dhe udhëhequr sukseshëm biznes.
- Pjesëmarrje në organizimin **“Duaje veten, bashkë ja dalim”**, për nder të muajit rozë, ku dëgjuam rrëfime të grave që kanë kaluar sfidën e sëmundjes së kancerit.

- Pjesëmarrje në tryezën “Si mund ta zvogëlojnë të drejtat pronësore rrezikun nga dhuna në familje?”, organizuar nga USAID.
- Protestë me moton “Nuk ka paqe pa sigurinë e grave”, me rastin e vrasjes makabre të Liridona Ademajt.



Foto 9 Aktivitet në Kuadër të Muajit Rozë



Foto 10 Protestë për Liridona Ademaj

Aktivitetet në vitin 2024:

- Organizimi për nder të **8 Marsit**: Nderim me mirënjohje për dy sportistët e shquara të komunës sonë, **Lirije Veselaj Bytyçi** (atlete dhe basketbolliste) dhe **Lumnije Latifi Thaçi** (atlete).
- Organizimi i aktivitetit sensibilizues “Eja, mos hezito” kundër kancerit të gjirit – Tetori Rozë.
- Ligjëratë nga Dr. Nazmi Kolgeci – Kirurg Torakal
- Leoreta Fondaj – rrëfim për sfidat e luftës kundër kancerit.



Foto 11 Aktiviteti me moton ‘Eja, mos hezito’



Foto 12 Aktiviteti me moton ‘Eja, mos hezito’

- Takim në organizatën **Handikos**, me rastin e Ditës së Personave me Aftësi të Kufizuara, ku u diskutuan sfidat dhe nevojat e tyre.
- Vizitë në strehimore për nder të fushatës “16 ditë aktivizëm kundër dhunës në baza gjinore”, me moton “Sot dhe çdo ditë tjetër”.
- Takim i hapur (për gjithë grupin e grave të kuvendit) i **Mekanizmit kundër dhunës në familje**, njëherit përmbyllës i fushatës për dhunë në baza gjinore.



Foto 13 Vizitë Strehimores në Prizren



Foto 14 Takimi i Mekanizmit kundër dhunës në familje

Aktivitetet në vitin 2025:

- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Gruas me ekspozitën **“Bota ime”**, me kuratore **Donjeta Kabashi**.
- Pjesëmarrje në aktivitetet e organizuara nga **Handikos** për nder të **1 Qershorit**, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.
- Hartimi i Raportit të Punës së Grupit për periudhën 2022-2025, mbështetur nga OSBE.
- Prezantimi i raportit para kandidateve për asamble komunale për zgjedhjet e 12 Tetorit 2025.



Foto 15 Foto nga ekspozita "Bota Ime"

3.3. Bashkëpunimi ndërkomunal dhe rrjetëzimi

Gjatë mandatit tonë, Grupi i Grave ka qenë aktiv dhe i përfaqësuar në shumë takime të organizuara nga organizatat joqeveritare dhe institucione që synojnë rrjetëzimin dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet grupeve të grave nga komunat e ndryshme të Kosovës. Konkretnisht, kemi marrë pjesë në takime të organizuara nga OSBE, ku kemi qenë pjesë e

diskutimeve mbi fuqizimin e gruas në vendimmarrje, ndryshimet në ligjin e zgjedhjeve, si dhe promovimin e Deklaratës Kundër Dhunës në Baza Gjimore. Për më tepër, kemi marrë pjesë në trajnime dhe takime të organizuara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, të cilët kanë trajtuar tema të rëndësishme, si ndikimi i grave në komunitet dhe forcimi i rolit të tyre politik dhe social.

Një hap i rëndësishëm ishte përfshirja jonë në projektin **“Bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Diasporës: Ngritja e kapaciteteve të grave në politikë në nivel lokal”**, mbështetur nga Germin. Në kuadër të këtij projekti, kemi marrë pjesë në disa trajnime me tematika të ndryshme dhe kemi nisur bashkëpunimin me një mentore nga diaspora, me qëllim implementimin e projektit në komunën tonë. Megjithatë, për shkak të disa sfidave dhe rrethanave të ndryshme, ky projekt mbeti i pezulluar.

Gjithashtu, kemi qenë pjesë e eventit vjetor të organizuar nga **NDI – Week of Women**, i cili promovon fuqizimin dhe përfshirjen e grave në proceset politike dhe shoqërore në nivel lokal dhe kombëtar.

Në secilin takim dhe aktivitet, kemi prezantuar arritjet tona, kemi ndarë përvojat konkrete dhe kemi qenë të hapura për të mësuar nga praktikatat më të mira të grupeve të tjera, duke e fuqizuar kështu rrjetin tonë ndërkomunal dhe duke përgatitur terrenin për bashkëpunim më të madh në të ardhmen.

Të arriturat dhe funksionimi i grupit, është vlerësuar nga OSBE dhe është marrë si model, ku të gjitha këto janë prezantuar në Konferencën vjetore të Grupeve të Grave në nivel të Kosovës.

3.4.Projektet dhe iniciativat strategjike

Gjatë këtij mandati, Grupi i Grave ka qenë aktiv në promovimin dhe implementimin e projekteve dhe iniciativave strategjike që synojnë fuqizimin ekonomik dhe profesional të grave në komunën tonë.

Subvencionimi i grave në start-up biznes

Si grup, kemi qenë propozuese kryesore që fondi për subvencionimin e grave në biznese të reja (start-up) të kalojë në Kuvendin Komunal. Kjo iniciativë ka për qëllim të mbështesë gratë që dëshirojnë të fillojnë apo të zhvillojnë bizneset e tyre, duke lehtësuar barrierat financiare dhe duke krijuar mundësi më të mëdha për pavarësi ekonomike. Grupi ka qenë i angazhuar në hartimin e udhëzimeve dhe shpalljes zyrtare të këtij fondi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave. Për më tepër, kemi qenë pjesë aktive e procesit të

monitorimit të zbatimit të marrëveshjeve me secilin biznes të subvencionuar, për të siguruar transparencë dhe efektivitet në përdorimin e burimeve. Përfituese kanë qenë rreth 13 biznese, me vlerë të përafërt 2500 Euro.



Foto 16 Vizitë bizneseve përfituese të subvencioneve komunale për start-up biznese

Financimi i bursave për gra dhe vajza në bashkëpunim me Akademinë ‘Vivene’

Një iniciativë tjetër me rëndësi ka qenë ndarja e **10 bursave** për gra dhe vajza, veçanërisht për ato në situata sociale të vështira apo të prekura nga dhuna në familje. Këto bursa kanë synuar avancimin profesional në fusha të ndryshme si rrobaqepësia, grimimi, dizajni dhe stilimi i flokëve.



Kjo iniciativë ka ofruar mundësi edukimi dhe aftësimi profesional, duke fuqizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë gratë dhe vajzat për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe për të rritur mundësitë e punësimit dhe të vetëpunësimit.

Foto 17 Foto nga event i organizuar nga Vivienne Academy në bashkëpunim me GGK

Këto projekte dhe iniciativa strategjike dëshmojnë angazhimin tonë për të përmirësuar pozicionin ekonomik dhe social të grave në Suharekë, duke krijuar një bazë të fortë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe barazinë gjinore në nivel lokal.

4. Sfidat kryesore për t’u adresuar në mandatin e ardhshëm

Pavarësisht arritjeve të konsiderueshme gjatë këtij mandati, disa sfida mbeten ende për t’u trajtuar me prioritet nga grupi i grave në mandatin e ardhshëm:

- **Përqindja e ulët e regjistrimit të pronave në emër të grave**, e cila vazhdon të jetë një pengesë për pavarësinë ekonomike dhe fuqizimin e tyre. Kjo përfshin edhe çështjen e trashëgimisë, ku pronat dhe pasuritë shpesh regjistrohen vetëm në emër të burrave.

- **Dhuna në familje**, e cila vazhdon të jetë një problem serioz dhe në shumicën e rasteve viktimat janë gratë. Është i nevojshëm thellimi i mekanizmave mbrojtës dhe ofrimi i mbështetjes efektive për viktimat.
- **Sfidat e nënave vetëushqyese**, të cilat përballen me vështirësi të shumta ekonomike, sociale dhe psikologjike, duke kërkuar mbështetje dhe politika sociale që i adresojnë këto nevoja në mënyrë gjithëpërfshirëse.
- **Mungesa e përfaqësimit gjinor 50% gra – 50% burra në institucionet publike dhe vendimmarrëse**, që kufizon mundësitë e barazisë së plotë dhe ndikon në marrjen e vendimeve me perspektivë gjinore.
- **Kërkesa për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe mbështetjes psikologjike për gratë në nevojë**, duke përfshirë viktimat e dhunës, gratë në situatë të vështirë ekonomike dhe komunitete të marginalizuara.
- **Nevoja për programe edukative dhe trajnime të vazhdueshme për barazinë gjinore**, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, për të ndërtuar një kulturë më të fortë të respektit dhe barazisë midis gjinive.
- **Pavarësimi ekonomik i grave**, të bëhet me projekte dhe iniciativa konkrete për fuqizimin e grave.
- **Të vazhdohet bashkëpunimi ndërmjet ZBGJ, ekzekutivit dhe legjislativit.**
- Përtej vijave politike, **Grupi të punojë dhe të angazhohet për qëllimet e përbashkëta.**

Adresimi i këtyre sfidave kërkon angazhim të vazhdueshëm, bashkëpunim ndër-institucional dhe zbatimin e politikave të dedikuara për të garantuar një mjedis më të drejtë dhe të sigurtë për gratë dhe familjet në komunën tonë.

Duke parë angazhimin dhe punën e palodhur gjatë këtij mandati, urojmë që Grupi i Grave në mandatin e ardhshëm të vazhdojë me përkushtim dhe energji të madhe. Qoftë ky një mandat i suksesshëm, ku do të forcohet përfaqësimi gjinor, do të avancohen të drejtat e grave dhe do të ndërmerren iniciativa të reja që do të sjellin ndryshime pozitive për të gjithë komunitetin. Ju urojmë suksese dhe bashkëpunim të frytshëm në rrugën drejt një Suhareke më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe me mundësi të barabarta për të gjitha gratë.

5. Përfundim nga Grupi i Grave (2022–2025)

Mandati ynë ka qenë një periudhë sfidash, mësimesh dhe arritjesh që na kanë fuqizuar si grup dhe na kanë afruar më shumë me komunitetin që përfaqësojmë. Gjatë këtyre katër viteve, kemi arritur të ndërtojmë ura bashkëpunimi, të zhvillojmë projekte të rëndësishme dhe të avancojmë çështjet që lidhen me barazinë gjinore në komunën tonë.

Jemi krenare për atë që kemi bërë, por gjithashtu jemi të vetëdijshme për sfidat që mbeten dhe përgjegjësinë që na takon për të vazhduar këtë rrugë. Ne i dorëzojmë detyrat tona grupit të ri me besimin se ato do ta çojnë më tej këtë punë të rëndësishme për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë.

Faleminderit për mbështetjen dhe bashkëpunimin gjatë këtij mandati. Bashkë për një të ardhme më të mirë!

Ky raport është përpiluar nga kryesuesja e Grupit të Grave në bashkëpunim me ZBGJ, Nënkryetaren e Komunës dhe anëtarët e GGK. Hartimi i këtij raporti është mbështetur nga misioni i OSBE në Kosovë, të cilët i falenderojmë për përkrahjen.